



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1037/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbare të kreditorit “V...” Sh.P.K., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, rr. “...”, nr..., përfaqësuar sipas autorizimit nga E.R, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr. 21/21, i lejuar me datë 15.01.2021, nga Përmbaresi Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, ashtu që Urdhri Përmbare P.nr. 21/21, i lejuar me datë 15.01.2021, nga Përmbaresi Privat Afet Mjeku, ANULOHET

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “V...” Sh.P.K., mbi bazën e faturës nr. 2018-838, të datës 27.12.2018, ka lejuar urdhrin për përmbare P.nr. 21/21, me datë 15.01.2021, me të cilin është urdhëruar debitori Qendra Klinike Universitare e Kosovës, që në bazë të faturës nr. 2018-838, e datës 27.12.2018, kreditorit t’ia paguaj detyrimin në lartësi prej EUR 940.00, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbare si dhe shpenzimet në emër të angazhimit të avokatit, në lartësi prej EUR 104.00, sipas rregullores mbi tarifat e avokatëve.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbare me arsyetim se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri është dorëzuar në kopje dhe se e njëjta nuk është pranuar nga debitori. Ka shtuar se kreditori nuk ka ofruar prova me të cilat do të provohej se debitori ka bërë porosi për kryerjen e shërbimeve të cilat kreditori

pretendon si dhe nuk ka bashkangjitur provë që ka pas të lidhur kontratë për kryerjen e punëve të pretenduara në mes kreditorit dhe debitorit, për të cilën gjë subjektet i obligojnë dispozitat ligjore të Ligjit të prokurimit. Poashtu, ka theksuar se propozimi për përmbarim nuk i përmban shënimet e kërkuara me dispozitat nga neni 29, 37, 38 dhe 40 të Ligjit për procedurën përmbarimore. Në fund, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj urdhrin për lejimin e përmbarimit.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur përgjigje në prapësim duke theksuar se pretendimi i debitorit se kreditori nuk ka ofruar prova me të cilat vërtetohet detyrimi i debitorit ndaj kreditorit nuk qëndron pasi që me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarim është dorëzuar edhe dokumenti i besueshëm – fatura e cila i përmban të gjitha kushtet ligjore për tu konsideruar si dokument i besueshëm. Ka shtuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi është pranuar nga personat përgjegjës në kuadër të debitorit dhe se e njejta është regjistruar dhe arkivuar pranë debitorit me datë 28.12.2018 dhe është regjistruar me numër të protokollit 6442. Poashtu, ka theksuar se pretendimi i debitorit se kreditori nuk ka ofruar prova se i njëjti ka kryer shërbime dhe se shërbimet e tij nuk janë të bazuara në ndonjë kontratë, nuk qëndron për arsye se sipas Ligjit për prokurimin publik për kuotimin e çmimeve, lidhja e kontratës publike nuk është e obligueshme. Në fund, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar dhe të obligohet debitori që kreditorit t'ia paguaj të gjitha shpenzimet procedurale, përfshi shpenzimet në emër të përgjigjes në prapësim, sipas rregullores mbi tarifat e avokatëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa, pika 1.3 e njejtij nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumta dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”

*monetar*”. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: “*Kur propozimi për përmba rim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet që e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjës i mungon nënshkrimi apo vula e debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, ndërsa ky i fundit të njëjtën e ka pranuar dhe është njoftuar me detyrimin që buron nga fatura.

Ndërsa, me vetëm faktin se fatura mban mbishkrimin se e njëjta është arkivuar, në mungesë të vulës së pranimi t të debitorit dhe të nënshkrimit nga personi përgjegjës pranë debitorit, gjykata nuk mund ta konsideroj si dorëzim të rregullt të faturës, përkatësisht pranim nga ana e debitorit. Prandaj, gjykata gjen se në rastin konkret fatura është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori, dhe rrjedhimisht nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmba rim, e mbi bazën e të cilit Përmba ruesi privat ka lejuar përmba rimin, nuk ka tipare të përmba rueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmba ruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1037/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.